

Konform nenit 15 al.2 dhe nenit 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr 2003/14 e zbatueshme sipas Rregullores së PSSP nr 2003/30, nenit 3 al. 1 pika b dhe nenit 4 të Rregullores për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr 2000/45, nenit 19 alineja 1, pika 2 dhe të nenit 39 alineja 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 1 prill 2004 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E PLANIT RREGULLUES
URBAN TË LAGJES "ORTAKOLL" NË PRIZREN

Neni 1.

Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Planit Rregullues Urban të lagjes "Ortakoll" në Prizren ("Fl.zyrtare e Kosovës" nr, 6/75) dhe e njëjta ndryshohet dhe plotësohet në atë mënyrë që në pjesët e ngastrave kadastrale nr. 7141, 7140/1, 7140/3 dhe 7140/4 në sipërfaqe të përgjithshme prej 2 ha e 59 ari e 40m² të destinuar, me Vendimin e mëparshëm për shërbime afariste zejtarë, parashihet ndërtimi i Kompleksit afaristo - banesor.

Neni 2.

Me ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të lagjes "Ortakoll" në Prizren (në tekstin e mëtejme të Planit rregullues urban) parashihet ndërtimi i Kompleksit afaristo-banesor, kulturor-sportiv, parkingjeve dhe rregullimi i hapësirës së lirë, kështu që, sipërfaqja dhe katshmëria e objekteve që do të ndërtohen është e përcaktuar në elaboratin teknik që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3.

Ndryshimi dhe plotësimi i Planit Rregullues Urban i paraqitur në elaboratin teknik është pjesë përbërëse e këtij vendimi me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin e hapësirës dhe të ndërtimit, me arsyetim të ndryshimit, të plotësimit dhe të destinimit.

Pjesa grafike përmban:

- paraqitja grafike e planit të ri rregullues urban, e vërtetuar me nënshkrimin dhe vulën e këtij organi.

Neni 4.

Obligohet Drejtoria për Çështje Pronëso-Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër e KK të Prizrenit që të bëjë zgjidhjen e marrëdhënieve pronëso-juridike me pronarë të objekteve dhe të shfrytëzuesve të tokës ndërtimore.


Neni 5.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor si dhe Drejtoria për Çështje Pronëso-Juridike, Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6.

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do shpallet në "Kumtar".

KUVENDI I KOMUNËS
Asambleja Komunale
Nr. 01/011-21
Më 1 prill 2004
Prizren



Kryetari i Kuvendit
Mr. Eqrem Kryeziu